




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/80
Datë: 03.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 79 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/80

Datë: 03.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 300.000 (treqind mijë) euro për rindërtimin e shtëpive në komunën e Mitrovicës.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Programi Shpenzimet e paparashikuara, kodi 232 - 131, kategoria ekonomike - rezervat dhe transferohen në Kuvendin Komunal të Mitrovicës, programi - " zhvillimi ekonomik" kodi 480 në kategorinë ekonomike; shpenzime kapitale.
3. Obligohet Ministra e Ekonomisë dhe Financave dhe Kuvendi Komunal i Mitrovicës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAJI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/80

Datë: 03.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Ndahen 68.000 (gjashtëdhjetetetë mijë) euro për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të mëtutjeshëm të kryetarit të Kuvendit Komunal të Istogut, z. Fadil Ferati.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi do të sigurohen nga programi i trajtimeve jashtë vendit - Programi Buxhetor 71600 dhe Kodi Ekonomik 21200, në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.
3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/80

Datë: 03.09.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 shtator 2009, mori

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës miraton rekomandimet e Komitetit Ndërministror dhe kompanisë konsulente "Eversheds" në partneritet me "American Global Consulting" në lidhje me ndërtimin e autostradës Morinë - Prishtinë.
2. Rekomandimet e Komitetit Ndërministror i bashkëlidhen këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

**RAPORT PER KOMITETIN NDER-MINISTROR MBI
KESHILLIMIN E TRANSAKSIONIT PER NDERTIMIN E
AUTOSTRADES MORINE – PRISHTINE**



EVERSHEDS ne partneritet me American Global Consulting jane perzgjedhur nga qeveria Kosovare per te keshilluar per transaksionin e ndertimit te Autostrades Morine – Prizren – Prishtine.

Pasi kemi shqyrtuar te gjithë informacionin e vene ne dispozicion nga Ministria e Transportit, ekipi yne ka pergatitur dhe perfunduar raportet dhe ka ndermarre hapat e nevojshme sipas parashikimeve ne fazen e pare.

Keto raporte permbajne:

- 1) **Raporti permbledhes:** ekipi yne analizon dhe meret me pergatitjen e formes se tenderimit, rishikimin e Preventivit, Specifikimet Teknike, Raportin Ligjor, sikurse dhe analizimin dhe rishikimin e te gjithë dokumentave qe gjinden ne pronesi te Qeverise se Kosoves.
- 2) **Raporti Paraprak** eshte i bazuar ne studimin e dezanjuar nga Gjermanet disa vite me pare dhe gjetjet jane:
 - Duhet te behen studime gjeomekanike per te zhvilluar nje projekt te plote.
 - Ndonese jane bere Matje me Lazer nga Ajri gjate gjithë korridorit te autostrades, hulumtimet duhet te vazhdojne si pasoje e ndryshimeve te vazhdueshme ne terren.
 - Gjithashtu, duhen bere rivendosje te aksit te korridorit per te garantuar nje korridor sa me eficient.
- 3) Per me teper, ekipi yne po studion dhe rishikon Preventivet ne gjendje ne relate me ndryshimet aktuale:
 - Eshte ndermarre nje analize dhe rishikimi i kostos per te pasur nje ide dhe parashikim sa me te sakte per projektin Morine – Prishtine.
 - Po analizojme opsionin me te mire te mundeshem per ndertimin e rruges duke i ndejtur besnik dizanjes qe kemi ne dispozicion. Megjithate, opsioni per kombinime te tuneleve dhe by-paseve eshte i hapur ne analizen tone per te siguruar opsionin me te mire per Qeverine.
 - Gjithashtu, ne analizen tone, gjithmone mbajme parasysh qe efekti ne ambient te jete sipas standarteve te Bashkimit European.
- 4) Ekipi yne ka pergatitur edhe raportin ligjor duke u bazuar ne ligjet e Republikes se Kosove dhe ne ligjet si me poshte:
 - Shpronesimit
 - Tokes
 - Ndertimit
 - Rugeve
 - Ambjentit
 - Sigurise

- Prokurimi Publik
- Koncesionet
- Punesimi dhe te tjera.

REKOMANDIME:

Duke mare parasysh analizen ne te cilen jemi bazuar, ekipi yne propozon si me poshte dhe bazuar ne grafikun kohor ne vazhdim:

- Propozojme nje Partneritet Publik Privat (PPP)
- PPP do te bazohet ne kontribute nga buxheti ne kombinim me kredi nga institucione financiare dhe/ose kompani ndertimi
- Ky opsion do te siguroje eficence dhe kohen e pershtatshme per realizimin e projektit
- Per me teper, kjo forme tenderimi do te mbaje nen kontroll koston e projektit sikurse dhe te siguroje alternativen me te mire per taksapaguesit Kosovar
- Gjithashtu, forma PPP do ta ndihmoje shtetin Kosovar ne sigurimin e financimit te rruges
- Ne vazhdim, kjo forme do te ndihmoje ne implementimin vendosjes se pagesave per perdorusit e rruges, ne kete menyre i lehteson barren fiskale qeverise se Kosoves ne financimin dhe me tej ne mirembajtjen e rruges
- Ne interes te publikut, opsioni me cmime fikse per unit do te garantoje jo vetem menaxhimin e koston, por edhe garanton punimet e shpejta ne ndertimin e rruges.

Ne propozojme nje grafik tenderimi si me poshte per te ecur perpara me projektin:

- Ekipi EVERSHEDES do te pergatise dokumentacionin e Tenderit per Supervizim ne bashkepunim me autoritetet Kosovare deri me date 12 Shtator 2009.
- Gjithmone ne bashkepunim me autoritetet kosovare, ftesa per Tenderin per ndertimin e autostrades Morine – Prishtine do te hapet brenda dates 25 Shtator 2009.
- Ne akord me Standartet Nderkombetare, ne parashikojme qe 30 dite te jene te mjaftueshme per kompanite qe kane treguar interes paraprakisht. Po ashtu, gjate kesaj periudhe 30 ditore mund te fillojme edhe negociatat per te pershpejtuar procesin.
- Perzgjedhja e kompanise fituese do te behet me transparence te plote dhe Brenda standarteve te Bashkimit European dhe Nderkombetare, duke i hapur rrugen per mobilizim te shpejte kompanise fituese.

LISTA E NGUSHTE

Pas analizimit te dokumentacionit te paraqitur nga 30 kompani qe kane treguar interes per ndertimin e Autostrades, ekipi yne ka pergatitur listen e shkurter duke perzgjedhur keto kompani ne rend alfabetik:

- Alpine
- Bechtel & Enka
- Makyol
- Pizzarotti
- Porr
- Strabag
- Terna

Keto kompani jane perzgjedhur duke u bazuar ne kriteret e paravendosura ne ftesen per shprehje interesi. Keto kriteret jane xhiroja vjetore mbi EUR 80 Milion ne 5 vitet e fundit, te kete ndertuar mbi 60 km autostrade ne 5 vitet e fundit, te kete kryer me sukses ndertimin e mbi 5 km tunel, te kete asistuar ne financimin e projekteve mbi EUR 100 Milion, sikurse dhe te kene realizuar projekte me sukses brenda buxhetit dhe afatit kohor te parashikuar.

Kompanite e perzgjedhura jo vetem permbushin keto kushte, por eksperienca nderkombetare dhe rajonale qe ato ofrojne jane elemente te rendesishem sigurie per ndertimin e autostrades me standarte te Bashkimit Europian.